



---

## OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

### PROCESVERBAL

### PËR PËRCAKTIMIN E ARSYEVE PËR MOSNDARJEN E PROCEDURËS SË PROKURIMIT NË LOTE ME OBJEKT “BLERJE DETERGJENTË PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BURGJEVE”

I mbajtur sot në datë 22.08.2024 nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit, për përcaktimin e arsyeve për mosndarjen e procedurës në lote, përkatësisht për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje detergjentë për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve”, me fondi limit **39,951,333** (tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind e pesëdhjetë e një mijë e treqind e tridhjetë e tre) **lekë pa TVSH** dhe **400,675** (katërqind mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë) **Euro pa TVSH** (Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë me datë 22.08.2024 është 99.71).

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote **sa herë kjo është e mundur**. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.  
2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.”*

Në zbatim të nenit të sipërpërmendur, Njësia e Prokurimit gjykon se kjo kontratë nuk mund të ndahet në lote pasi kemi të bëjmë me të njëjtën natyrë mallrash, që në thelb i përkasin së njëjtës kategori. Pra nga ana teknike dhe organizative është e nevojshme kryerja e furnizimit me mallrat objekt prokurimi në një procedurë të vetme.

**NJËSIA E PROKURIMIT**